

HAKI STËRMILLI DHE SAMUEL RIÇARDSONI, DITARËT DHE LETËRKËMBIMET (ASPEKTI KRAHASIMTAR)

Artesa OSMANAJ-MAVRAJ¹

¹Phd candidat of Faculty of Philology, University of Prishtina „Hasan Prishtina”

^{*}Corresponding author e-mail: artesa.osmanaj@yahoo.com

Përmbledhje

Temën me titull “*Haki Stërmilli dhe Samuel Riçardsoni, ditarët dhe letërkëmbimet*” e japim si propozim për **Seminarin XVII Ndërkombëtar i Albanologjisë** sepse, po t’i shikojmë në pamje të parë, figurën e Stërmillit dhe të Riçardsonit do të na duken pa asnjë pikë takimi, duke e ditur që fillimisht njëri i takon letërsisë angleze e tjetri letërsisë shqipe. Megjithatë duhet nënvizuar se kur lexuam romanet e të dyve, në një vështrim më të detajuar, na ranë në sy paralelizma të cilat më së shumti shihen në pjesën tematiko-përmbajtësore, e cila pjesë na shërbeu për të operuar e krahasuar. Më saktësisht, të dy autorët janë parë si figura qendrore të sentimentalizmit si fenomen letrar, në letërsinë shqipe dhe angleze, ku ky fenomen gjeti shprehje në zhanrin e romanit dhe këtu para së gjithash kujtojmë këta dy autorë.

Fjalët kyçe: proza, krahasimi, proza sentimentale shqipe, proza sentimentale evropiane.

Afritë dhe dallimet

Po t’i shikojmë në pamje të parë, figurën e Stërmillit dhe të Riçardsonit do të na duken pa asnjë pikë takimi, duke e ditur që fillimisht njëri i takon letërsisë angleze e tjetri letërsisë shqipe. Megjithatë duhet nënvizuar se kur lexuam romanet e të dyve, në një vështrim më të detajuar, na ranë në sy paralelizma të cilat më së shumti shihen në pjesën tematiko-përmbajtësore, e cila pjesë na shërbeu për të operuar e krahasuar. Më saktësisht, të dy autorët janë parë si figura qendrore të sentimentalizmit si fenomen letrar, në letërsinë shqipe dhe angleze, ku ky fenomen gjeti shprehje në zhanrin e romanit dhe këtu para së gjithash kujtojmë këta dy autorë. Duke iu referuar shkrimit të studiuesit Osman Gashi që: “*Romani shqiptar mbeti përgjithësisht një jehonë a rudiment i brishtë e i flashkët i veprave të ndryshme evropiane*”,¹⁶ arritëm në një konkluzion që romani “Sikur t’isha djalë” i autorit Haki Stërmilli, është një vepër sentimentale, e shkruar në formën e ditarit dhe e ndërtuar në ngjashmëri me modelin, që është romani “Pamela” i Samuel Riçardsonit.

¹⁶ Osman Gashi, “*Peshorja e parkave*”, studime mbi letërsinë dhe kulturën, Prishtinë, 2019, fq. 75.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v11.i21-22.p2586>

Dallimin si vepër sentimentale, përveç në narracionin me stil sentimentalist, e hetojmë edhe në bazë të ndarjes që bën teoricieni Milivoj Solar i cili romanet sentimentale i vendosë në ndarjen e dytë e sipas të cilit; “*Mënyra e dytë e klasifikimit të romanit është e lidhur me qëndrimin e autorit dhe me tonin e përgjithshëm të romanit. Në këtë rrafsh më së shpeshti flitet për romanin sentimental, humoristik, satirik, didaktik dhe tendencioz*”.¹⁷ Pavarësisht që nuk kemi dëshmi apo edhe nuk ekzistojnë të tilla, që vërtetojnë se Stërmilli ka lexuar diçka nga Riçardsoni, ky studim mundohet të shqyrtojë ngjashmëritë e mundshme mes letërsive konkretisht autorëve, ku hetohet një ndërlidhje në mes këtyre dy veprave, si në strukturë, tematikë deri diku, diskurs, situata e në kohë.

Dhe elementi që i lidh autorët më konkretisht dhe që është bazë e fenomenit të sentimentalizmit, ka të bëjë me ndjenjë, me natyrën shpirtërore të personazheve që i kanë në roman. T’i shohim me radhë; ngjarja në të dy romanet rrëfëhet nga protagonistja e cila mediton, filozofon, proteston dhe vepron. Në të dy rastet kemi të bëjmë me dorëshkrime, të shkruara në letra, ditar dhe me ngjarje që kanë të bëjnë ose kanë lidhje me kohën e autorit, të cilët kanë karakteristikë interesin drejt botës intime të njeriut. Megjithëse zhanri i romanit epistolar tashmë ekzistonte dhe ishte përhapur mbi të gjitha në Francë, Richardsoni vlerësohet se e ka ngritur këtë zhanër në nivele të larta dhe çdo roman tjetër epistolar anglez është bazuar në punën e tij.

Pikërisht, ky rrëfim për të tashmen në të dy romanet është jehonë protestuese, pasi nuk synohet pajtueshmëria me ndrydhje apo cenueshmëri të jetës, lirisë, por të pasqyrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë lëvizja shoqërore apo idetë e saj. Wellek dhe Warren do të thoshin: “*Një histori mund të tregohet në formë letrash ose ditarësh, ose mund të shtjellohet mbi bazën e një anekdote*.”¹⁸ Realisht, ato janë rrëfime, histori të treguara, në letra dhe ditarë që shkruhen nga vetë personazhet Dija dhe Pamela, mbi jetën e tyre, zhvillimin, idetë, privimet, duke përdorur karakterin e tyre, virtytet për të ruajtur cilësinë, vlerën e prioritetin e femrës në shoqëri. Rreziku nga mospërfillja e femrës, nëpërkëmbja e saj në shoqëri, nënshtrimi ndaj familjes dhe shoqërisë në një pozitë të mjeruar me ligje patriarkale, i shoqërojnë këto dy vepra fund e krye.

Romanet “Sikur t’isha djalë” dhe “Pamela”, duke qenë romane sentimentale, i kanë të përbashkëta edhe elementet e poetikës sentimentaliste si: rrëfimin në vetën e parë, rrëfimin sentimental, letrat-ditarin, vëmendjen ndaj mendimeve dhe ndjenjave, tensionin narrativ, emocionet plot theks, stilin dramatik, motivin e përballjes, demaskimin e ironinë etj. Zemra e romanit “Pamela” është historia e një shërbyesje gjashtëmbëdhjetë vjeçare, me një bukuri të madhe dhe një virtyt edhe më të madh, e cila i reziston përpjekjeve të joshjes së zotërisë së saj, me të cilin është gjithashtu e dashuruar sinqerisht, derisa të arrijë ta çojë atë në martesë. Është një rrëfim i përpiktë i jetës së përditshme të shekullit ’18-të, por mbi të gjitha i përsosjes e analizës psikologjike.

Richardson në fakt përfaqëson emocionet e protagonistit me një gjallëri dhe hollësi të rrallë dhe gjen në formën e re të romanit epistolar mjetin më të përshtatshëm për shprehjen e asaj "ndjenjeje" në shekullin e ’18-të. Romani “Sikur t’isha djalë” i Haki Stërmillit, nis me një parathënie apo paratekst, që i paraprin historisë së rrëfyer në roman, apo siç e cilëson teoricieni francez Zherar Zhenet “*peritekst*”¹⁹, njëjtë sikur “Pamela” që në fillim përfshin pjesën paratekstore që ka të bëjë me shpjegimin e shkurtër të secilës letër, tridhjetë e dy sa janë dhe një ditari të shkurtër në fund. Në të vërtetë këto janë tekste mbështetëse që janë jashtë rrëfimit bazë, por që luajnë rol të madh në zbërthimin dhe ecurinë e vijës narrative.

¹⁷ Milivoj Solar, “*Teoria e letërsisë*”, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 226.

¹⁸ Rene Wellek, Austin Warren, “*Teoria e letërsisë*”, Onufri, 2015, fq. 229.

¹⁹ Zherar Zhenet, “*Figura*” përkthyer Sabri Hamiti, Binak Kelmendi, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 184.

Dija e mban ditarin gjatë gjithë kohës si ngushëllim rrëfyes e ndër të tjera shkëmben letra, me njerëzit e zemrës siç është Shpendi, gjersa Pamela shkruan dhe shkëmben letra gjatë gjithë kohës me prindërit që vinin nga shtresa e varfër dhe në fund rrëfen në ditar. Një njeri në automobil, Hamiti, rrugës edhe me disa bashkudhëtarë kishte në duar një pako amanet prej Dijes, e cila e shtyente atë ta hapte se çka kishte në të. Aty pa që kishte një defter, një shami e një letër drejtuar të dashurit të saj Shpend Rrëfes. Dhe kështu ky njeri nis e lexon disa prej pjesëve që i kishte shkruar Dija, gjersa kur arrin në qytetin Zuna, në mbrëmje nis e shfleton të tërë fletorin e Dijes. Kjo histori e lexuar nga Hamiti do të bëhet ngjarje e romanit. Përmes kësaj pjese paratekstore kuptohet që kemi të bëjmë me një histori të rrëfyer nga dikush tjetër, pikërisht nga narrator-personazh dhe që botohet si amanet i saj nga Hamiti dhe Shpendi.

Distancimi i Stërmillit nga rrëfimi dhe hyrja e përfundimi, nënkuptojnë se historia që po lexojmë është dorëshkrim i Dijes. *“Ndërsa ata po i argëtojshin fantazit e tyre me andrrime e dëshirime për një jetë paradisore, un po mendohesha nën përshtypjen e hidhët që më kish lanë sëmundja e Dijes. Më dukej sikur nuk do t’a shifsha ma. Pakon që më kish dhanë ajo e kisha marrë me vetëhe. Dishka më nxitte me e hapë dhe me pamë se ç’ ishte shkruar n’at defter që ajo më dorëzoi. Ma në fund më munda kërshëria dhe e çela pakon. Mbrenda kishte një defter, një shami të bardhë dhe një letër të drejtuar Zotni Shpend Rrëfes në Tiranë. Gati tri të katërtat e fletorit ishin të shkruara Menjiherë e njofta shkrimin e imët të Dijës. Në faqën e parë ishte shkruar, me ngjyrë të kuqe, ky titull: Jeta e eme. Vendosa të këndoj disa pjesë sa për t’a kënaqë kërshërin.”*²⁰

Të njëjtën lojë e ndërton edhe Richardsoni në romanin e tij “Pamela”, por për dallim nga Stërmilli, Richardsoni e nis romanin e tij me pjesën paratekstore që është si shpjegim i vogël për letrat e radhës, duke filluar me vëllimin e parë. Pra, përmes këtyre shenjave shpjeguese apo indeksi të letrave, kuptojmë se ajo çka do të lexojmë janë disa letra nga Pamela shkruar nga ajo dhe marrë prej saj dhe në fund një ditar i saj. Kryesisht letrat u drejtohen prindërve të saj, vijnë nga prindërit e saj dhe kthehen si përgjigje prapë për prindërit e saj. Aty rrëfëhet për çdo ndodhi që Pamela kalon, fillimisht për vdekjen e zonjës së saj, shqetësimin që kishin prindërit pas vdekjes së zonjës dhe sigurinë që Pamela ua jep prindërve, që vrytytin moral e njerëzor do ta vendos të parin në jetë. Pra, siç thotë edhe studiuesi Xhonatan Kaller, *“Të treguarit mund të ndjekë menjëherë ndodhi të veçanta si në romanet epistolare (romane në formën e letrave), si në Pamelën e Samuel Riçardson ku çdo letër merret me çka ndodhi deri në atë pikë”*²¹.

Të dy autorët e vendosin rrëfimin në nivel të dytë, ku autori thotë diçka që ka thënë rrëfyesja apo protagonistja e tyre, Dija apo Pamela. Siç shprehen studiuesit Wellek dhe Warren, *“Rrëfimi i një historie në vetën e parë (Ich-Erzählung) është një metodë që duhet peshuar me kujdes karshi të tjerave. Një rrëfimtari i tillë, natyrisht nuk duhet ngatërruar me autorin.”*²² Autori në “Sikur t’isha djalë”, ndoshta është i dukshëm vetëm në hyrje dhe përfundim, përkundër të “Pamela” që fillon menjëherë me letrat e saj, domethënë me shkëmbimin rrëfyes të letrave të saj.

Dorëshkrimi i Dijes, i cili është një shfryerje e një mllëfi e mërzisë për ndryshim e emancipim, të njëjtën kohë është ruajtje e krenarisë dhe moralit. Letrat e Pamelës në tjetrën anë ishin gjithashtu një lloji manuali për kodifikimin e sjelljes shoqërore dhe mbetën shembull edhe për romane të tjera nga mesi i shekullit ’18-të, e fillim i shekullit ’19-të. Lexuesi ka mundësi që të shohë perceptimin e saj jetësor, si heroinë, zhvillimin e karakterit, ku morali tregohet si triumf i durimit të karakterit femër, virtytit dhe modestisë.

²⁰ Haki Stërmilli, *“Sikur t’isha djalë”*, Rilindja, Prishtinë, 1980, fq. 5-6.

²¹ Xhonatan Kaller, *“Teori letrare”*, Një hyrje e shkurtër, përktheu Blendi Kraja, SH.B.T. “ERA”, Prishtinë, 2001, fq. 92.

²² Rene Wellek, Austin Warren, *“Teoria e letërsisë”*, Onufri, 2015, fq. 229.

Letter III.

“Dear Father, I must needs say, that your Letter has fill'd me With much Trouble. For it has made my Heart, Which Was overflowing with Gratitude for my young Master's Goodness, suspicious and fearful; and yet, I hope I never shall find him to act unEorthy of his Character; for What could he get by ruining such a poor young Creature as me? But that which gives me most Trouble is, that you seem to mistrust the Honesty of your Child. No, my dear Father and Mother, be assur'd, that, by God's Grace, In ever will do any thing that shall bring your grey Hairs with Sorrow to the Grave. I Will die a thousand Deaths, rather than be dishonest any way. Of that be assur'd, and set your Hearts at rest; for altho' I have liv'd above myself for some Time past, yet I can be content with Rags and Poverty, and Bread and Water, and will embrace them rather than forfeit my good Name, let Who Will be the Tempter. And of this rest satisfy'd, and think better of Your dutiful Daughter till Death. My Master continues to be very affable to me. As yet I see no Cause to fear any thing Mrs. Jervis the House-keeper too is very civil to me, and I have the Love of every body. Sure they can't all have Designs against me because they are civil. I hope I shall always behave so as to be respected by every one; and hope nobody Would do me more hurt, than I am sure I would do them. Our John so often goes your Way, that I Will always get him to call that you may hear from me, either by Writing, for it brings my Hand in, or by Word of Mouth ”²³

Letra e tretë

“I dashuri baba, më duhet të them, që letra jote më ka mbushur me shumë telashe, sepse e ka bërë zemrën time, e cila ishte e tejmbushur me mirësinë e mjeshtrit tim të ri, të dyshimtë dhe të frikshme, e megjithatë shpresoj se kurrë nuk do ta gjejë atë të veprojë i padenjë për karakterin e tij; sepse çfarë mund të merrte ai duke shkatërruar një krijesë kaq të re e të varfër si unë? Por ajo që më shqetëson më shumë është se ti dukesh se nuk i beson sinqeritetit të fëmijës tënd. Jo, i nderuari baba dhe nënë e imja, jini të sigurtë që me mirësinë e Zotit, në çdo kohë do të bëjë çdo gjë që të mos i sjellë flokët tuaj gri me pikëllim në varr. Unë do të vdes njëmijë vdekje, para se të jem e pandershme në çfarëdo mënyre. Të jeni të sigurt për këtë dhe t' i qetësoni zemrat tuaja, ngase edhe pse në të kaluarën kam jetuar për ca kohë mbi veten time, megjithatë mund të jem i-e kënaqur me lekat dhe varfërinë, bukën e ujin dhe do t' i përfaqoj ato në vend që të humbas emrin tim të mirë, të jetë kush të jetë çekuilibruës –tundues në jetën time (cilido të jetë). Dhe për këtë pushoni të qetë dhe mendoni vetëm mirë për vajzën tuaj të devotshme deri në vdekje. Mjeshtri im vazhdon të jetë shumë i dashur me mua. Deri me tani unë nuk shoh asnjë shkak për tu frikësuar nga ndonjë gjë. Edhe zonja Jevris, kujdestarja e shtëpisë është shumë e sjellshme me mua dhe unë kam dashurinë e të gjithëve. Sigurisht që ata nuk mund të kenë të gjithë synime kundrejt meje ngase ata janë të sjellshëm. Shpresoj se gjithmonë do të sillem në atë mënyrë që të respektohem nga të gjithë; dhe shpresoj se askush nuk do të më bëjë më keq, ngase jam e sigurt se do u bëjë edhe unë atyre. Gjoni jonë shkon kaq shpesh në rrugën tënde, sa që unë gjithmonë do ta bëjë atë të dëgjosh nga unë, qoftë duke shkruar qoftë me fjalën e gojës, sepse më bën të kontribuoj.”²⁴

Kështu, ajo shihet si një intelektuale që mund të mendojë për veten e saj duke e ruajtur moralin e sjelljen, më shumë se sa një amvise që punon plotësisht e që varet nga burri i saj. Ajo është shërbëtoare që detyrueshëm plotëson vullnetin e zotëriut të vet, duke na shfaqur në mënyrë të kuptueshme tiraninë e burrit dhe pavarësisht sjelljeve të tij, ajo duhet t' i bindet atij. Ruajtja e pastërtisë morale nga ana e protagonistëve është element i ngjashëm në të dy romanet, përkundër që dy të rejtat kanë një jetë të varfër dhe kërkojnë që një të pasur e të arritshme ta kenë me ndershmëri dhe me punë.

²³ Pamela or, Virtue Rewarded, Vol. 1 (public-library.uk) SAMUEL RICHARDSON, PAMELA,

²⁴ Pamela or, Virtue Rewarded, Vol. 1 (public-library.uk) SAMUEL RICHARDSON, PAMELA,

Femra në romanin sentimental evropian, pa u hamendësuar i nënshtrohet burrit, derisa në sentimentalizmin shqiptar ajo përballet rëndë, por revoltohet, qoftë edhe në planin emocional. Luftën e saj e zhvillon për dinjitet, liri e pozitë të qenësishme. Përlulja dhe “lufta”, sikur janë dy dallime të qenësishme në mes këtyre dy tipesh grashë. Mes këtyre dy veprave ka disa ngjashmëri mes situatave ashtu siç ka tipare të veçanta të personazheve. Edhe pse në letërsinë e sentimentalizmit evropian gruaja paraqitet ndryshe, kjo figurë femërore është në të dy romanet një personazh tepër tërheqës, naiv që lë mbresa të jashtëzakonshme, po që fatkeqësisht shkakton edhe dhembje për fatin e saj të nënshtroar ndaj ambientit të mbyllur dhe rregullave e ligjeve të egra kanunore (Dija), e për jetën e rëndë sociale e të qenurit shërbëtore e dikujt (Pamela).

Të dyja janë sfiduese dhe karakterizimi i tyre bëhet nëpërmjet përsiatjeve reflektuese që shquajnë tiparin mbizotërues të tyre. Edhe Dija e Stërmillit, edhe Pamela e Riçardsonit e sfidojnë ankthin e së përditshmes. Studiuesi francez, Yves Chevrel, thotë se *”krahasimi mes letërsive të gjuhëve të ndryshme është baza e studimeve komparativistike”*²⁵, sepse duhet pasur parasysh letërsitë e ndryshme prej nga vijjnë shkrimtarët, ku në mes tyre ka dallime domethënëse, por ka edhe ngjashmëri të forta sidomos në mënyrën se si shkrimtarët e përceptojnë unin letrar dhe konceptin e të shkruarit. Proza e Stërmillit në këtë studim është analizuar në një mënyrë krahasuese me prozën e Riçardsonit, ku sentimentalizmi buron nga tekstet ashtu edhe nga kontekstet kulturore.

Në të dy romanet autori mundohet të shpreh atë se gruaja në mënyrë të veçantë është e rrethuar me një pafundësi forcash të brendshme të cilat tentojnë që t’ua formësojnë atyre këndvështrimin për vetën e jetën. Brenda realitetit objektiv dhe realitetit të brendshëm psikologjik femra trajtohet si pjesë e pandarë e botës poetike të shkrimtarëve. Ky personazh, e re në moshë, 15 e 17 vjeçare, është vënë në qendër të interesit tematik duke shpalosur gjithë dhembjen e madhe që mbartin si shkak i absurditetit të ekzistencës dhe gjithë forcën e karakterit për t’i bërë ballë, edhe pse kjo përballje nënkupton vdekje ose nënshttrim. Një aspekt të veçantë, që e gjejmë në të dy personazhet femërore, është transparenca e tyre, duke refuzuar çdo lloj maske dhe veprojnë ashtu siç e ndiejnë, të devotshme e të pafajshme.

Dija dhe Pamela janë deri diku modeli i ngjashëm i femrës, përafërsisht të së njëjtës moshë, që për t’u ndier të gjalla, të dobishme, të vlerësuara në sy të shoqërisë, ndonjëherë revoltohen, nuk ua ndien për të tjerët, ndonjëherë pajtohen dhe çdoherë ruajnë, ndoshta mund ta quajmë “egoizmin” dhe moralin si vlerë. Të tilla janë të vërteta dhe asgjë nuk mund t’i tjetërsojë. Një tjetër element që i përbashkon të dy romanet, është shpërfaqja e ndjenjave. Në njërën anë prindërit e Pamelës ndiejnë dhimbje e interes për të, gjersa në rastin e Dijes dashuria e prindit bëhet interes për jetën e tij. Samuel Richardson i kushton vëmendje të veçantë mendimeve dhe ndjenjave të Pamelës ashtu si Stërmilli mendimeve, mendimeve e ndjenjave të Dijes.

Të dy romanet në përgjithësi janë rrëfime mbi feminizmin duke hedhur poshtë pikëpamjet tradicionale, duke mbështetur ndryshimet e grave në shoqëri. Feminizmi dallohet pikërisht aty ku lexuesit i lejohet të shehë thellësitë e grave (emocionet, ndjenjat, mendimet e tyre). Letrat e saj, na lejojnë të shohim figurativisht se si ndihet ajo në lidhje me ngjarjet e zhvilluara që ndodhin në jetën e saj dhe se si ajo zgjedh t’i trajtojë këto ngjarje. Ajo shihet si një intelektuale e pavarur që mund të mendojë për veten e saj njëjtë sikur Dija të cilën në rrëfimin e saj e shohim si një intelektuale në mendime përparimtare e me gjykime të drejta. Të varfëra, të vrytyshme e tejet të bukura, përshkruhen të dy protagonistet. Elementi i vetëvrasjes është mendim që prek mendjen e të dyjave.

²⁵ Yves Chevrel, *“Letërsia e krahasuar”*, përktheu Ali Xhiku, Albin, Tiranë, 2002, f. 154.

Dija për jetën e rëndë dhe martesën e padëshirueshme me burrin e vjetër, e Pamela për jetën e imponueshme e sjelljet e këqija nga Z. B, djali i Zonjës B. Autori iu jep qëllimisht ngjyra shpresëdhënëse në shpirt, duke iu zgjuar besim në vete, bukuri e begati. Personazhi i Stërmit në fund stërkeqet nga vuajtja e mundimi e sëmundja dhe nuk heq dorë nga morali e parimet e veta dhe vdes duke lënë amanet prioritetin e femrës shqiptare dhe botimin e shkrimeve të veta. Në anën tjetër Pamela e Richardsonit edhe përkundër frikës që nuk i takonte klasës së duhur për t'u martuar me z. B, ajo bindet nga vetë z.B dhe martohet me të. Në letrën e fundit, pra të 32-tën me radhë ajo u drejtohet për herë të fundit prindërve të saj, duke shfaqur mërzinë e pakënaqësinë e saj.

Në njëfarë mënyre mërzitë e dhimbjet e Dijes nuk mbarojnë deri në vdekje për dallim nga Pamela e cila më vonë gjen një rahat e lumturi të krijuar me shumë mund nga z. B. Në pjesën e dytë të romanit ajo martohet me Z. B dhe përpiqet të përshtatet me pozicionin e saj të ri në shoqërinë e klasës së lartë. Ajo nuk harron që ishte e varfër prandaj kur martohet me z.B ndihmon ata dhe mundohet të jetë e dinjitetshme në klasën së cilës i është bashkuar. Në aspektin e bamirësisë Pamela ngjan me Emën, personazhin e Jane Austenit, e cila angazhohej në vizita e takime me qëllim bamirësie. *“Ema ishte e zënë me një vizitë bamirësie në një familje të varfër e të sëmurë, që banonte në periferi të Hajbërit”*²⁶.

Në fund të rrëfimit, lexuesi do të shohë dy heronjtë të martuar, të lumtur dhe të pranuar nga shoqëria e kohës (megjithëse mesazhi që Pamela ngjitet është një unikum, i lindur në sajë të cilësive të tij të pazakonta). Tema e femrës, emancipimit të saj është lakuar shumë nga autorët sentimentalë shqiptarë. Romani “Sikur t’isha djalë”, ndonëse si shënjes në titull ka dëshirën me qenë djalë, në kontekst emancipimin e në tekst socialen, në fakt temë bosht ka atë të femrës në shoqëri, e cila, edhe në romane të tjera tërheq vëmendjen, duke dhënë ide e motiv. “Pamela” është përshkruar si një pjesë e letërsisë feminist, sepse hedh poshtë pikëpamjet tradicionale të gruas dhe mbështet rolin e ri dhe ndryshimet e grave në shoqëri. Richardsoni favorizoi stilin epistolar sepse ai besonte se kjo e sillte lexuesin në kontekst më të ngushtë me botën emocionale dhe psikologjike të shkrimit të letrave. Mendojmë që të dy autorët e romaneve, mundohen të përhapin idenë se, bota e brendshme e një personi nuk varet nga statusi i tij shoqëror.

²⁶ Jane Austen, “Ema”, Shqipëroi Ledia Dushi, Botime Pegi, Gusht, 2014, fq. 83.